

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Sazani- Zverneci te Tirana “pa kokë”, Rama flet troç: S'kam ndërmend të zgjedh pasardhës! Kur të kapërcëj prapun e derës, do shpëtoni nga unë (INTERVISTA)
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/nga-sazani-e-zverneci-te-bashkia-e-tiranes-pa-koke-rama-flet-troc-une-n-i400511
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 06:57:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 06:48:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	88b6f6e0517aaa8895f95070340a88021f85740f1088c1a904f5e04b5c42a07e
TEKSTI	98f3b0e517e714f5b1405f46a4be555418a7c49ae302321744027a500aaf94d2
PAMJA	421b5e960dde6317181cf34cac65a00ae8a4319521c1a315a06e5a0c5657d26f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e8f92df6391ec1c7e935680d46d2a4345630dc836469084850971fead4af7810
E MËPARSHMJA	e96f6303543ed711e144bec8f9d1e204990f3c51ebe9b9f0ec7be71d9c7df7e0
RRËNJA MERKLE	590baac6c4f2849cba88a9c97beece944a2facab4f12f8937e153132e53136c9
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	Qmekd6BFYFEWABFFs3Smecj47nXVJZ4Wj4QrYBZunJ441f



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e8f92df6391ec1c7e935680d46d2a4345630dc836469084850971fead4af7810>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Politikë

6 Shtator 2026, 08:48

Nga Sazani- Zvërneci te Tirana "pa kokë", Rama flet troç: S'kam ndërmend të zgjedh pasardhës! Kur të kapërcej pragun e derës, do shpëtoni nga unë (INTERVISTA)



Shkruar nga Newsbomb



Ilustrim: Zvërneci, Edi Rama, Bashkia Tiranë

Kryeministri Edi Rama ka zgjedhur të nisë sezonin e ri të podcastit të tij "Flasim" me disa ndryshime që nuk kanë kaluar pa u vënë re. Në podcastin e tij të parë për sezonin e ri, Edi Rama duket se nuk është në rolin e moderatorit por të intervistuarit.

Përballë gazetares Rudina Xhunga, kreu i qeverisë shqiptare ka zgjedhur të flasë për temat më të bujshme të këtij viti, duke nisur që nga ishulli i Sazanit, Zvërneci, e deri te politikanët socialistë, me në fokus kryebashkiakun e Tiranës Erion Veliaj, i cili duke qenë se është paraburgim prej më shumë se dy vitesh, kryeqyteti ka mbetur "pa kokë".

Referuar videos së shpërndarë në rrjet nga vetë Rama, lë të kuptohet se intervista e dyshes është goxha e gjatë, pasi kryeministri ndryshe nga zakonisht, është përgatitur për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të shumta. Duke nisur intervistën me batuta, Rama fillimisht ndalet te çështja e cila ka ngritur peshë shqiptarët, ishullin e Sazanit, për të cilën thekson se ai nuk ka shitur tokat e Shqipërisë.

"Ata nuk po blejnë ishullin. Ata as nuk po marrin pronësinë mbi ishullin. Ai ishull do të jetë pronë e Republikës së Shqipërisë. Nuk jam shitësi i Shqipërisë" thekson Rama.

Më tej kryeministri ndalet dhe te puna e SPAK, për të cilën thekson se ka gabuar duke përdorur mediat duke baltosur njerëzit të cilët ka marrë nënë akuzë për çështje të tilla.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Foto e Ditës

Shpresë për paqe pas 4 vitesh lufte Ukrainë-Rusi



Aktualitet

Zjarri bën "kërdinë", digjen 4 kioska te Syri i Kaltër, shkrumbohen dy makinat private të policëve në Fier (DETAJE)


Zbulu më shumë artikuj >

"Kjo është një nga gjërat më të këqija që ka bërë SPAK-u, që ka përdorur mediat për të baltosur ata të cilët do të merrte nën akuzë. Kjo nuk bëhet. Koha tregoi që unë kisha investuar në një maskë karnavalesh. Prokurori bashkë me një gjykatës u bashkuan bashkë në një dhomë dhe vendosën që të bëjnë kryeministrin, parlamentin dhe presidentin. Unë këtë s'mund ta pranoj" vijon më tej reagimi i Ramës.

Duke vijuar më tej, te situata aktuale e bashkisë Tiranë për të cilën thekson se "zemra" e Shqipërisë është pa kokë, Rama e cilëson këtë si një eksperiment social.

Në përmbyllje të videos së shpërndarë ditën e sotme, e cila tregon fragmente nga intervista e plotë, Rama nënvizon se pushteti është një kafshë e përbindshme e cila ka tjetërsuar goxha burra. Ndërsa theksoi sërish se kur të dorëzojë karrigen, atëherë socialistët e qytetarët do të kenë shpëtim nga ai.

"Pushteti është një kafshë e përbindshme, ka ngrënë e ka futur nën vete shumë burra. Ai që të sfidon dhe bëhet pasardhës, ai do të të vrasë. Unë personalisht nuk kam ndërmend të zgjedh pasardhës. Në momentin që unë e kapërcej pragun e asaj dere, ju do të shpëtoni nga unë" tha kryeministri.



Intervista:

Edi Rama: Ti do i bësh vërtet 300 pyetje sot?

Rudina Xhunga: Po, vërtet.

Edi Rama: Maratonë?

Rudina Xhunga: Pse, nuk do ti?

Edi Rama: Jo, jo dakord.

Rudina Xhunga: Jo, unë kam vetëm hallin që ata më shohin kështu si...

Fjala e Edi Ramës:

Ka qenë një krim i mandatuar dhe një nga dy ekzekutorët është një njeri plotësisht i njohur për mua, të dy e dinim. Ata nuk po blejnë ishullin. Ata as nuk po marrin pronësinë mbi ishullin. Ai ishull do të jetë pronë e Republikës së Shqipërisë. Nuk jam shitësi i Shqipërisë.

Kjo është një nga gjërat më të këqija që ka bërë SPAK-u, që ka përdorur mediat për të baltosur ata të cilët do të merrte nën akuzë. Kjo nuk bëhet. Koha tregoi që unë kisha investuar në një maskë karnavalesh. Prokurori bashkë me një gjykatës u bashkuan bashkë në një dhomë dhe vendosën që të bëjnë kryeministrin, parlamentin dhe presidentin. Unë këtë s'mund ta pranoj.

Bashkia nuk ka kokë. Është një eksperiment social, politik dhe ekonomik ky që një kryeqytet të drejtohet pa kokë. Është një talent, talent i madh politik që nuk e mbajti

Njëqytet të drigjtonet pa kockë, por të një kalenë, kalenë i madh për të qe nuk e merrja dot peshën. Pushteti është një kafshë e përbindshme, ka ngrënë e ka futur nën vete shumë burra. Ai që të sfidon dhe bëhet pasardhës, ai do të të vrasë. Unë personalisht nuk kam ndërmend të zgjedh pasardhës.

Edi Rama: Në momentin që unë e kapërcej pragun e asaj dere, ju do të shpëtoni nga unë.

Rudina Xhunga: Mos më shko në fund se do të të pyes, kemi akoma pyetje.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Shtunë 22:01

Zjarret "pushtuan" Shqipërinë, Rama zbret vetë në terren për të parë dëmet dhe jep mesazhin: Ç'nuk na vret, na bën më t'fortë (VIDEO)



Politikë

Ish-nënkryetari i PD-së ironizon protestuesit: Keni mbi 90 ditë që thoni "ju erdhi fundi", por po zvogëloheni vetë

🕒 E Shtunë 20:32



Politikë

"Zonat që digjen, nuk mund të kthehen në hotele dhe resorte", Braçe shpërthen ndaj kritikëve: Kur do të kërkon ndëshkimin e piromanëve?

🕒 E Shtunë 18:28



E Shtunë 16:30

"Sfidon" Berishën, Florjan Binaj rishpall kandidaturën për Bashkinë e Tiranës: Kryeqyteti duhet t'u rikthehet qytetarëve



Politikë

Nga Spiropali te ish-ministri, ja deputetët socialistë që "refuzuan" urdhrin e Ramës dhe nuk dolën në terren për "Praninë Besnike"

E Premte 20:33



Politikë

"PRANIA BESNIKE" nis në të gjithë Shqipërinë, Rama tregon si do të funksionojë: Të gjitha problemet nuk do të mbetet pa u adresuar

E Premte 19:32



E Premte 18:59

Udhëtimi i Berishës për në SHBA, Salianji: Lajm i mirë, por nuk mjafton për ta larguar Ramën! Të japë dorëheqjen



Politikë

Dy ushtarakë në përplasjen e Radhimës, Ministria e Mbrojtjes: Shërbejnë në Policinë Ushtarake prej viti 2006, por nuk janë shoqëruesit personalë të ministrit Ermal Nuri (REAGIMI)

E Premte 17:27



Politikë

Pas më shumë se 6 javësh pushime, Kuvendi rikthehet në punë të martën! Miratohet rendi i ditës

E Premte 17:27





🕒 E Premte 17:02 Newsbomb

Sofia Moreira de Sousa nis misionin e saj

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.